

Prof. dr. Adem Bunguri



Ka lindur me 10 mars 1954 në fshatin Grevë të Peshkopisë. Ka kryer studimet e larta në Universitetin “L. Gurakuqi” të Shkodrës në vitin 1977. Gjatë vitit 1982 kryen me rezultate të shkëlqyera kursin e specializimit pasuniversitar të arkeologjisë pranë Qendrës së Kërkimeve Arkeologjike (më vonë Instituti i Arkeologjisë) të Akademisë së Shkencave Tiranë. Që atëherë punon si arkeolog në Departamentin e Prehistorisë të Institutit Arkeologjik, në vitet 1983-2003 në Bërthamën Arkeologjike të Peshkopisë, ndërsa nga viti 2003 në Tiranë. Ka kryer disa fushata gërmimesh sistematike në rajonin e Dibrës, si në vendbanimet prehistorike të Topojanit (1987-1989), të Pesjakës (1991), të Manasdrenit (2002-2003), të Blliçes (2005), të kalasë së Peshkopisë (2006) dhe të Burimit (2007), si dhe disa gërmime shpëtimi në qendra arkeologjike të këtij rajoni, si në kalanë e Grazhdanit (1983, 2009), kapelën e Pesjakës (1986), varret monumental të Zall-Sinës (1986) dhe të Kurtbegut (1987), në varrezën e dystë të Sofraçanit (2008) etj.

Në vitin 1991 ka mbrojtur në Departamentin e Prehistorisë disertacionin me temë **“Neoliti dhe Eneoliti në luginën e mesme të Drinit të Zi”** për gradën **“kandidat i shkencave”**, në vitin 1996 ka fituar titullin **“Doktor i shkencave”**, në vitin 2000 ka fituar titullin **“Mjeshtër kërkimesh” ose “Prof. assoc”** dhe në vitin 2011 ka fituar titullin **“Drejtues Kërkimesh” ose “Profesor”**. Ka drejtuar sektorë të veçantë të gërmimeve prehistorike në vendbanime prehistorike në rajone të ndryshme të Shqipërisë, si në Podgorie (Korçë 1982), Benjë (Përmet 1983), Zagorë (Shkodër 1987), Konispol (Sarandë 1993), Sovjan (Korçë 1996, 2000, 2001) dhe Grazhdan (1983, 2009) si dhe në nekroplet tumulare të Bujanit (Tropojë 1984, 1986), Myç-Hasit (Kukës 1988) etj.

Ka drejtuar gërmimet arkeologjike në fushën e arkeologjisë prehistorike në rajonin e Dibrës (1986-2008), si dhe kërkimet prehistorike në Kosovë gjatë projektit **“Kërkime Arkeologjike në Kosovë”(2000-2008)**, dhe ka bashkëdrejtuar gërmimet në vendbanimet prehistorike në Kosovë (2002-2011) si në Hisar (2003-2004), Vlashnje (2002, 2006-2008, 2010), Korishë (2002, 2006) dhe Reshtan (2010-2011).

Ka dhënë leksione të Arkeologjisë së Përgjithshme në Universitetin “L. Gurakuqi” të Shkodrës (2002-2003) dhe në Universitetin “A. Moisiu” të Durrësit (Programi Master DND) (2010-2011), dhe leksione të Arkeologjisë Prehistorike në Universitetin e Prishtinës (2004-2009) dhe në Universitetin Shtetëror të Tiranës (2006-2008), si dhe ka zhvilluar leksionet e **Arkeologjisë Prehistorike, pjesa II (Epoka e Bronzit dhe e Hekurit)**, në

programin e shkollës “Master DND”(2009-2014) dhe atë të shkollës Doktorale (2011-2014) pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike Tiranë. Zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe ka njohuri të mjaftueshme në atë gjermane.

Ka botuar mbi 30 artikuj shkencorë në revista arkeologjike në Shqipëri, FYROM, Kosovë, Slloveni dhe Gjermani dhe ka marrë pjesë në disa kongrese arkeologjike ndërkombëtare, siç është Kongresi mbi Neolitin në Ljubljane (2013), Kongresi Ndërkombëtar Arkeologjik në Tiranë (2013) etj. Duke filluar nga viti 2010 e në vazhdim, ai shpenzon një ose dy muaj çdo vit në DAI në Frankfurt (Gjermani) dhe DAI në Istanbul (Turqi), për të shfrytëzuar bibliotekat e tyre shumë të pasura, që kanë përmirësuar ndjeshëm cilësinë e punës së tij shkencore. Gjatë qëndrimeve të tij studimore në DAI Frankfurt am Main, ai ka mbajtur leksione mbi çështje të ndryshme të Arkeologjisë Prehistorike të Shqipërisë dhe Kosovës.

Interesat e tij shkencore janë përqëndruar në studimin e kulturës së epokës së bronzit në Shqipëri dhe në Kosovë, të lidhur ngushtë me proceset e formimit etno-gjenetik të popullsisë ilire në Ballkanin Perëndimor.

Veprimtaria shkencore në terren (gërmimet)

a. Projekte gërmimi në rajone të ndryshme të Shqipërisë:

- 1982: *Gërmime në vendbanimin neolitik të Podgories, Korçë*(Drejtues F. Prendi)
- 1983: *Gërmime në vendbanimin shpellor të Benjës, Përmet* (Drejtues M. Korkuti)
- 1984: *Gërmime në nekropolin tumular të Bujanit, Tropojë* (Drejtues Zh. Andrea)
- 1986: *Gërmime në nekropolin tumular të Bujanit, Tropojë* (Drejtues Zh. Andrea)
- 1987: *Gërmime në vendbanimin prehistorik të Zagorës, Shkodër* (Drejtues Zh. Andrea)
- 1988: *Gërmime në nekropolin tumular të Myç-Hasit, Kukës* (Drejtues M. Bela)
- 1993: *Gërmime në vendbanimin shpellor të Konispolit, Sarandë* (Drejtues M. Korkuti)
- 1996: *Gërmime në vendbanimin prehistorik të Soujanit, Korçë* (Drejtues F. Prendi).
- 2000: *Gërmime në vendbanimin prehistorik të Soujanit, Korçë* (Drejtues F. Prendi)
- 2001: *Gërmime në vendbanimin prehistorik të Soujanit, Korçë* (Drejtues P. Lera)

b. Projekte gërmimi në rajonin e Dibrës:

- 1983: *Gërmime në kalanë e Grazhdanit, Dibër* (Drejtues D. Komata)
- 1986: *Drejtues i gërmimeve të shpëtimit në kapelën e Pesjakës, Dibër.*

- 1986: *Drejtues i gërmimeve të shpëtimit në varrin monumental të Zall-Sinës, Dibër.*
- 1987: *Drejtues i gërmimeve të shpëtimit në varrin monumental të Kurtbegut, Dibër.*
- 1987: *Drejtues i gërmimeve në vendbanimin prehistorik të Topojanit, Dibër.*
- 1988: *: Drejtues i gërmimeve në vendbanimin prehistorik të Topojanit, Dibër.*
- 1989: *: Drejtues i gërmimeve në vendbanimin prehistorik të Topojanit, Dibër.*
- 1991: *Drejtues i gërmimeve në vendbanimin prehistorik të Pesjakës, Dibër.*
- 2002: *Drejtues i gërmimeve në vendbanimin prehistorik të Manasdrenit, Dibër.*
- 2003: *Drejtues i gërmimeve në vendbanimin prehistorik të Manasdrenit, Dibër.*
- 2005: *Drejtues i gërmimeve të kontrollit në vendbanimin prehistorik të Blliçes, Dibër.*
- 2007: *Drejtues i gërmimeve të kontrollit në vendbanimin neolitik të Burimit, Dibër.*
- 2008: *Drejtues i gërmimeve të shpëtimit në varrezën e dystë të Sofraçanit, Dibër.*
- 2009: *Gërmime në kalanë e Grazhdanit, Dibër (Drejtues L. Përzhita)*

c. Projekte gërmimi në Kosovë:

- 2002: *Bashkëdrejtues në gërmimet e vendbanimit prehistorik të Vlashnjës, Prizren (E. Shukriu-A. Bunguri-Sh. Gashi)*
- 2002: *Bashkëdrejtues në gërmimet e vendbanimit prehistorik të Korishës, Prizren (A. Bunguri-Sh. Gashi).*
- 2003: *Bashkëdrejtues në gërmimet e vendbanimit prehistorik të Hisarit, Suharekë (A. Bunguri-Sh. Gashi).*
- 2004: *Bashkëdrejtues në gërmimet e vendbanimit prehistorik të Hisarit, Suharekë (A. Bunguri-Sh. Gashi).*
- 2006: *Bashkëdrejtues në gërmimet e vendbanimit prehistorik të Korishës, Prizren (A. Bunguri-Sh. Gashi).*
- 2006: *Bashkëdrejtues në gërmimet e vendbanimit prehistorik të Vlashnjës, Prizren (A. Bunguri-Sh. Gashi).*
- 2007: *Bashkëdrejtues në gërmimet e vendbanimit prehistorik të Vlashnjës, Prizren (A. Bunguri-Sh. Gashi).*
- 2008: *Bashkëdrejtues në gërmimet e vendbanimit prehistorik të Vlashnjës, Prizren (A. Bunguri-Sh. Gashi).*
- 2010: *Bashkëdrejtues në gërmimet e vendbanimit prehistorik të Vlashnjës, Prizren (A. Bunguri-Sh. Gashi).*
- 2010: *Bashkëdrejtues në gërmimet e vendbanimit prehistorik të Reshtanit, Suharekë (A. Bunguri-Sh. Gashi).*
- 2011: *Bashkëdrejtues në gërmimet e vendbanimit prehistorik të Hisarit, Suharekë (A. Bunguri-Sh. Gashi).*

Bibliografia Shkencore

a. Raporte gjermimesh & survejsh:

1. **BUNGURI Adem, Gjermimet arkeologjike të vitit 1987-TOPOJAN** (*The archaeological excavations of the year 1987 in Topojan*), "Iliria", 1987,2, f.237-238.
2. **BUNGURI Adem, Gjermimet arkeologjike të vitit 1988 - TOPOJAN** (*The archaeological excavations of the year 1988 in Topojan*), "Iliria", 1988,2, f.246-247.
3. **BUNGURI Adem, Gjermimet arkeologjike të vitit 1989 - TOPOJAN** (*The archaeological excavations of the year 1989 in Topojan*), "Iliria", 1989, 2, f.262-264.
4. **BUNGURI Adem, Raport mbi gjermimet e shpëtimit të vitit 1986 në varrin monumental të Zall-Sinës**, Arkivi i Institutit Arkeologjik(me tej: AiA), Tiranë.
5. **BUNGURI Adem, Raport mbi gjermimet e shpëtimit të vitit 1986 në kapelën e Pesjakës**, AiA, Tiranë.
6. **BUNGURI Adem, Raport mbi gjermimet e shpëtimit të vitit 1987 në varrin monumental të Kurtbegut (Maqellarë)**, AiA, Tiranë.
7. **BUNGURI Adem, Raport mbi gjermimet e kontrollit të vitit 1991 në vendbanimin ilir të Pesjakës**, AiA, Tiranë.
8. **BUNGURI Adem, Raport mbi survejin e vitit 1999 në luginën e Drinit të Zi**, AiA, Tiranë.
9. **BUNGURI Adem, Raport mbi survejin e vitit 2001 në vendbanimet prehistorike kodrinore në luginën e Drinit të Zi**, AiA, Tiranë.
10. **BUNGURI Adem, Raport mbi gjermimet arkeologjike të vitit 2002-2003 në vendbanimin prehistorik të Manasdrenit (Dibër)** AiA, Tiranë.
11. **BUNGURI Adem, Raport mbi gjermimet e kontrollit të vitit 2005 në vendbanimin prehistorik të Bllaçës (Dibër)**. AiA, Tiranë.
12. **BUNGURI Adem, Raport mbi gjermimet e kontrollit të vitit 2006 në kalanë e Peshkopisë (Dibër)**. AiA, Tiranë.
13. **BUNGURI Adem, Raport mbi gjermimet e kontrollit të vitit 2007 në vendbanimin prehistorik të Burimit (Dibër)**. AiA, Tiranë.
14. **BUNGURI Adem, Raport mbi gjermimet arkeologjike të vitit 2002 në vendbanimin prehistorik të Vlashnjes (Prizren)** AiA, Tiranë, Prishtinë
15. **BUNGURI Adem-GASHI Shafi, Raport mbi gjermimet arkeologjike të vitit 2006 në vendbanimin prehistorik të Vlashnjes (Prizren)** AiA, Tiranë, Prishtinë.
16. **BUNGURI Adem-GASHI Shafi, Raport mbi gjermimet arkeologjike të vitit 2007 në vendbanimin prehistorik të Vlashnjes (Prizren)** AiA, Tiranë, Prishtinë.

17. **BUNGURI** Adem-GASHI Shafi, **Raport mbi gërmimet arkeologjike të vitit 2008 në vendbanimin prehistorik të Vlashnjes(Prizren)** AiA, Tiranë, Prishtinë.
18. **BUNGURI** Adem-GASHI Shafi, **Raport mbi gërmimet arkeologjike të vitit 2010 në vendbanimin prehistorik të Vlashnjes (Prizren)** AiA, Tiranë, Prishtinë.
19. **BUNGURI** Adem-GASHI Shafi, **Vlashnje (Prizren)**, « Iliria » XXXIV, 2009-2010, f. 388-389.
20. **BUNGURI** Adem, **Raport mbi resurset arkeologjike që ndodhen në territorin ku do të ndërtohet HC i Skavicës (Dibër)** AiA, Tiranë 2007.
21. **BUNGURI** Adem-GASHI Shafi, **Raport mbi gërmimet arkeologjike të viteve 2003-2004 në vendbanimin prehistorik të Hisarit (Suharekë)** **AiA, Tiranë, Prishtinë.**
22. **BUNGURI** Adem-GASHI Shafi,, **Raport mbi gërmimet arkeologjike të vitit 2002 në vendbanimin prehistorik të Korishës (Prizren)** AiA, Tiranë, Prishtinë.
23. **BUNGURI** Adem-GASHI Shafi, **Raport mbi gërmimet arkeologjike të vitit 2006 në vendbanimin prehistorik të Korishës (Prizren)** AiA, Tiranë, Prishtinë.
24. **BUNGURI** Adem, **Raport mbiurvejin e vitit 2000 në komunën e Pejës (Kosovë)** AiA, Tiranë, Prishtinë.
25. **BUNGURI** Adem, **Raport mbiurvejin e vitit 2001 në komunën e Gjakovës (Kosovë)** AiA, Tiranë, Prishtinë.
26. **BUNGURI** Adem, **Raport mbiurvejin e vitit 2002 në komunën e Prizrenit (Kosovë)** AiA, Tiranë, Prishtinë.
27. **BUNGURI** Adem, **Raport mbiurvejin e vitit 2004 në komunën e Rahovecit (Kosovë)** AiA, Tiranë, Prishtinë.
28. **BUNGURI** Adem, **Raport mbiurvejin e vitit 2004 në komunën e Drenasit (Kosovë)** AiA, Tiranë, Prishtinë.
29. **BUNGURI** Adem-GASHI Shafi, **Raport mbi gërmimet arkeologjike të viteve 2010-2011 në vendbanimin prehistorik të Reshtanit (Suharekë)** AiA, Tiranë, Prishtinë.
30. **BUNGURI** Adem-GASHI Shafi, **Reshtan (Suharekë)**, « Iliria » XXXVI, 2012, f. 379-385.
31. PËRZHITA Luan- **BUNGURI** Adem- LUCI Kemal,- KOÇBASHLLIU Luan, **Gjetje të hershme mesjetare në Banjë të Malishevës (Raport paraprak i gërmimeve arkeologjike të vitit 2007)**, « Candavia» 3, 2011, f. 363-371.
32. **BUNGURI et al** 2011: A. BUNGURI- R. GAUß and C. RUMMEL in collaboration with: SH. GJONGECAJ, S. ALIU, I. GJIPALI, B. LAHI, P. LERA, **Geomagnetic prospections by the Institute of Albanology, Tirana and the Roman Germanic Commission of the German Archaeological Institute, Frankfurt am Main, 2011 Campaign, Arkivi i Insitutit Arkeologjik, Tiranë, Frankfurt am Main.**
33. **BUNGURI** Adem, **Raport mbiurvejin e vitit 2011 mbi vendbanimet e fortifikuara prehistotrike të luginës së Drinit të Zi,** AiA, Tiranë
34. **BUNGURI** Adem, **Raport mbiurvejin e vitit 2014 mbi vendbanimet e Bronzit të Hershëm në pellgun e Shkodrës,** AiA, Tiranë.

b. Artikuj shkencor:

1. **BUNGURI** Adem, **Armë ilire në krahinën e Dibrës** (*Illyrian weapons from the region of Dibër*) "Iliria", 1989, 1, f. 67-73, 1 fig., 2 tab. Përmb.fr.

Prejardhja e gjetjeve. Paraqitja e tyre sipers funksionit dhe tipit: Armë sulmi (maja shigjetash bronzi, shpatë hekuri me maja heshtash hekuri). Armë mbrojtëse: përkrenare bronzi e tipit ilir.

2. **BUNGURI** Adem, **Vendbanimi neolitik i Topojanit** (*The Neolithic settlement of Topojan*), "Iliria", 1991, 1-2, f.5-27, 4 fig., 11 tab., Përmb.fr.

Pozita gjeografike e vendbanimit. Stratigrafia dhe veçimi i dy periudhave Topojan I e II. Qeramika: teknika e punimit, format e enëve, zbukurimet, analogjitë tipologjike me kulturat e tjera të neolitit të mesëm. Disa veçori lokale të zhvillimit të saj.

3. **BUNGURI** Adem, **Gjetje nga varreza e Gjoricës së Poshtme (Rrethi i Dibrës)** (*Findings from the graveyard of Gjoricë e Poshtme*), "Iliria", 1992, 1-2, f. 301-312, 1 fig., 3 tab. Përmb. fr.

Gërmimet e shpëtimit në varrezën e Gjoricës dhanë varre të shek.II-IV dhe XI-XII të e.sonë. Në radhë kronologjike jepet katalogu i enëve të prodhimit vendas dhe katalogu i enëve të importit, i ndarë sipers funksionit dhe tipit të objektit që përfaqëson.

4. **BUNGURI** Adem, **Vendbanimi neolitik i Topojanit (Faza Topojan II)** (*The Neolithic settlement of Topojan - Topojan II phase*), "Iliria", 1993, 1-2, f.33-94. Përmb.fr.

Shtrirja e vendbanimit dhe stratigrafia e Topojanit II. Arkitektura. Veglat e punës. Qeramika sipers tri kategorive: me fakturë mesatare, të hollë dhe të trashë. Format e enëve sipas tipeve e varianteve. Zbukurimet. Objektet e kultit. Pozita kulturore e kronologjike e Topojanit II (neoliti i vonë)

5. **BUNGURI** Adem, **Vendbanimi ilir i Pesjakës (Dibër)** (*The Illyrian settlement of Pesjakë in Dibër*), "Iliria", 1994, 1-2, f.87-97, Përmb.fr.

Pozita gjeografike e vendbanimit. Sondazhet dhe stratigrafia. Analiza e gjetjeve i kushtohet tërësisht qeramikës. Teknika e punimit. Tipat e variantet e enëve dhe zbukurimet. Raportet kulturore e kronologjike me kulturat e vendbanimeve të tjera. Datimi i vendbanimit - fundi i bronzit dhe fillimi i epokës së hekurit.

6. **BUNGURI** Adem - **KORKUTI** Muzafer, **Kultura e epokës së bronzit në vendbanimin e Cetushit.** (*La civilization du bronze dans le site de Cetush*). Botuar te : "Iliria", 1996, 1-2, f. 5-19, 6 tab. Rés. fr.

- 7.. **BUNGURI** Adem, *Periudhat postneolitike të vendbanimit të Topojanit*. (Les périodes postnéolithiques de l'agglomération du Topojan). Botuar te : "Iliria", 1997, 1-2, f. 57-84, 13 tab. Rés. fr.
8. **BUNGURI** Adem, *Aspekte të zhvillimit prehistorik në pellgun e Dibrës në dritën e zbulimeve të reja arkeologjike*, Dibra dhe etnokultura e saj, (Dibër (FYROM)19-21 .11. 1993), vol. I, Dibër 1995, f.24-31.
9. **BUNGURI** Adem, *Mbi urbanizimin antik dhe të mesjetës në krahinën e Dibrës*, Dibra dhe etnokultura e saj, (Dibër(FYROM) 19-21 .11. 1993), vol. I, Dibër 1995, f. 44-53.
10. **BUNGURI** Adem-GASHI Shafi, *Të dhëna të reja mbi kronologjinë e Hisarit*, "Kosova Arkeologjike", I, 2005, Prishtinë 2006, f. 11-20.
11. **BUNGURI** ADEM, *Kapela e Pesjakes (Dibër)*, „Candavia“ 2, 2005, f. 381-386.
12. PËRZHITA Luan- LUCI Kemajl-HOXHA Gëzim-BUNGURI Adem-PEJA Fatmir-KASTRATI Tomor, « *Harta Arkeologjike e Kosovës* », I, Prishtinë 2006, 393 faqe.
13. **BUNGURI** Adem, *Pellgu i Drinit të Bardhë në prehistori*, « Harta Arkeologjike e Kosovës », I, Prishtinë 2006, f. 27-43.
14. **BUNGURI** Adem, *Drini i Bardhë area in Prehistory*, Harta Arkeologjike e Kosovës, I, Prishtinë 2006, f. 44-55.
15. **BUNGURI** Adem -LUCI-Kemajl-KASTRATI Tomor, *Qendra prehistorike*, « Harta Arkeologjike e Kosovës », I, Prishtinë 2006, f. 57-127.
16. **BUNGURI** Adem, *Tipare të qytetërimit neo-eneolitik në Rrafshin e Dukagjinit(Kosovë)*, Vepra themelore në Albanologji, Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare(18-20.12. 2008), Tiranë 2009, f. 301-315, 1 hartë, 5 figura.
- 17.PËRZHITA Luan- LUCI Kemajl-HOXHA Gëzim-BUNGURI Adem-PEJA Fatmir- KASTRATI Tomor, *Përnjohje arkeologjike në Kosovë (2000-2005), Harta Arkeologjike e Kosovës, I)*, Vepra themelore në Albanologji, Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare (18-20.12. 2008), Tiranë 2009, 289-300.
- 18.**BUNGURI** Adem, *Gjetje nga kalaja e Grazhdanit*, « Monumentet » 2007, f. 100-121.
19. **BUNGURI** Adem, *Dy varre monumentalë në rajonin e Dibrës*, « *Monumentet* » 2008, f. 117-31, 5 skica, 10 figura.
20. **BUNGURI** Adem, *Frano Prendi-një jetë për arkeologjinë(Frano Prendi-a life in Archaeology)*, « *Iliria* » XXXIII, 2007-2008, f. 12-25, 5 fig.
- 21.**BUNGURI** Adem, *Kalaja e Koxhaxhikut (Dibër)*, « *Studime Historike* » 2009, 1-2, f. 27-56, 2 skica, 32 figura.
22. **BUNGURI** Adem, *Të dhëna të reja mbi neolitit dhe eneolitit në Kosovë*, « *Iliria* » XXXIII, 2007-2008, f. 47-82. 8 fig. 17 tab.
- 23.**BUNGURI** Adem,*Të dhëna arkeologjike nga Çidhna e Poshtme (Dibër)*, « *Candavia* », 3, 2011, f.197-219.
24. **BUNGURI** Adem *Prof. Frano Simon Prendi (1928-2011), Një jetë kushtuar arkeologjisë- In Memoriam*, « *Hylli i Dritës* », 2012 (janar-mars), nr. 1, Shkodër 2012, f. 72-91.

25. **BUNGURI** Adem, *Sëpata dyshe prjej bronzi në Shqipëri (Bronze double axes from Albania)*, « Iliria » XXXVI, 2012, f. 7-45.
26. **BUNGURI** Adem, *Të dhëna të reja mbi periudhën e vonë romake, atë të vonë antike dhe mesjetare në rajonin e Dibrës*, « Candavia » 4, 2012, 163-191.
27. **BUNGURI** Adem, *Some aspects of the Early Bronze Age in Albania and Kosovo*. In : International Congress of Albanian Archaeological Studies, Proceedings of the International Congress of Albanian Archaeological Studies, 65-th Anniversary of Albanian Archaeology (21-22 November 2013), Tirana 2014, f. 121-140.
28. **BUNGURI** Adem, *Different models for the Neolithisation of Albania, Documentae Praehistoricae*, XLI, Ljubljana 2014, 79-94.
29. **BUNGURI** Adem, *Vështrim arkeologjik në zonën e Zerqanit*, Konferencë shkencore me rastin e 117 vjetorit të shkollës së parë shqipe të Zerqanit (14.05. 2010) « Profili i Komunës Zerqan », Tiranë 2015, f. 15-21.
30. **BUNGURI** Adem (Instituti Arkeologjik Tiranë) – **GAUß** Roland (Römische-Germanische Konission Des Deutsches Archäologische Institute, Frankfurt am Main), *The bronze axes in Albania (Sëpatat e bronzit në Shqipëri)*, “Prähistorische Bronzefunden”, München 2015 (në proces botimi).
- 31.

c. Konferenca shkencore :

1. **BUNGURI**, Adem, *Vështrim mbi prehistorinë e rajonit të Dibrës*, Sesioni I shkencor arkeologjik, Peshkopi, 08.12. 1984.
2. **BUNGURI**, Adem, *Mardhënjet ekomomiko-kulturore midis dy Dibrave në kontekstin arkeologjik*, Dibër e Madhe (FYROM), 13-14.04. 2000.
3. **BUNGURI**, Adem, *Vështrim mbi prehistorinë e Kosovës*, Universiteti i Prishtinës, Kosovë 20.11. 2001.
4. **BUNGURI**, Adem, *Prehistoria e rajonit të Gjakovës*, Instituti i Monumenteve të Gjakovës, Kosovë, 21.11. 2001.
5. **BUNGURI**, Adem, *Edhe njëherë mbi kalanë e Sfetigradit*, Simpoziumi i 600 vjetorit të lindjes së Skënderbeut, Dibër e Madhe (FYROM), 18.11. 2005.
6. **BUNGURI**, Adem – **GASHI** Shafi, *Të dhëna të reja mbi kronologjinë e Hisarit*, Simpoziumi historik, Suharekë (Kosovë), 25.11. 2005.
7. **BUNGURI**, Adem, *Dibra si një njësi e lashtë në konfiguracionin etno-kulturor ilir*, Simpoziumi “Dibra dhe Rruga e Arbërit”, Tiranë, 09.06. 2008.
8. **BUNGURI**, Adem, *Vështrim arkeologjik në zonën e Zerqanit*, Bulqizë, 14.05. 2010.
9. **BUNGURI**, Adem, *Different models for the Neolithisation of Albania* (The 20th Neolithic Seminar, “Changing Paradigms for Interpreting the transition to Neolithic in Eurasia”, Ljubljana 8-9 November 2013).
10. **BUNGURI**, Adem, *Tipare të kulturës së Bronzit të Hershëm në Shqipëri e Kosovë dhe problemi gjenetik* (Kongresi Ndërkombëtar i Arkeologjisë, Tiranë, 20-21 Nënëtor 2013).

11. BUNGURI Adem-GASHI Shafi, *Të dhëna të reja mbi kulturën e epokës së bronzit në Kosovë*. L'Illyrie Méridionale et L'Épire dans L'antiquité, VIe colloque international, Tirana 20-23 mai 2015.

12. BUNGURI Adem, BUNGURI Bunguri (2016), *Relations between Mycenaean world and Albania during Middle and Late helladic (as reflected from imported Mycenaean weapons and tools)* (16th INTERNATIONAL AEGEAN CONFERENCE ΕΣΠΕΡΟΣ / HESPEROS THE AEGEAN SEEN FROM THE WEST, University of Ioannina. 18-21 May 2016 (in print).

d. Hauskolloquim in DAI (Frankfurt am Main):

1. BUNGURI Adem, *The Early Bronze Age Civilisation in Albania. Hauskolloquim*. In Konfrenzraum in Palmengartenstrasse, 28.04.2010.

2. BUNGURI Adem, *The Neolithic Civilisation of Kosovo. Hauskolloquim*. In Konfrenzraum in Palmengartenstrasse, 18.11.2011.

3. BUNGURI Adem, *The Copper and Bronze Axes and tools in Albania. Hauskolloquim*. In Konfrenzraum in Palmengartenstrasse, 23.11.2012.

d. Monografi :

1. BUNGURI Adem, *Neoliti dhe Eneoliti në luginën e mesme të Drinit të Zi (Disertacion)* (Biblioteka e Institutit Arkeologjik (sigla: **0042-47**) Biblioteka Kombëtare (sigla: **05-11/13F**), Tiranë 1996, 165 fq., 14 figura, 63 tabela.

2. PRENDI Frano-BUNGURI Adem, *Bronzi i hershëm në Shqipëri (The Early Bronze Age in Albania)*, Prishtinë 2008, 346 fq, 43 figura, 64 tabela.

3. PRENDI Frano-BUNGURI Adem, *Studime për Prehistorinë e Shqipërisë*, Tiranë 2014, f. 417, 78 figura, 173 tabela.

4. BUNGURI Adem, *“Prehistoria e Dibrës”*, Tiranë 2010, f. 327, 71 figura, harta & diagrama, 122 tabela.

5. PRENDI Frano-BUNGURI Adem, *Bronzi i hershëm në Shqipëri (The Early Bronze Age in Albania)*, Prishtinë 2008, 346 fq, 43 figura, 64 tabela.

6. Harta Arkeologjike e Kosovës, I (grup autorësh) Prishtinë 2006, 393 fq.

7. Harta Arkeologjike e Kosovës, II (grup autorësh) Prishtinë 2012, 332 fq.

d. Editime (BUNGURI Adem-GASHI Shafi):

PRENDI Frano, *Studime Arkeologjike, I* (Përmbledhje e artikujve në shqip), p. 895, 15 harta, 113 figura, 213 tabela, 24cm.

ISBN-978-9951-555-01-2, Prishtinë 2008. Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës. © 2008 OJQ “ARG-KOS”-Mr.Sc. Shafi Gashi.

2.PRENDI Frano, *Archaeological Studies, II* (Përmbledhje e artikujve në gjuhë të huaj), p.751, 12 harta, 195 figura, 166 tabela, 24cm.

ISBN-978-9951-555-02-9, Prishtinë 2008. Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës © 2008 NGO “ARG-KOS”-Mr.Sc. Shafi Gashi

3.ISLAMI Selim, *Kultura ilire e tumave të Matit*, p. 161, 26 figura, 60 tabela, 21cm.

ISBN-978-9951-604-00-0, Prishtinë 2013. Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

g. Albume:

1.Katalog Arkeologjik i Kosovës (Archaeological Catalogue of Kosovo) (grup autorësh), Prishtinë 2013.

2. Album Arkeologjik i Shqipërisë (grup autorësh), Tiranë 2013.